



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE

KOMISIONERI SHTETËROR I ZGJEDHJEVE

Data: 30 Qershor 2022

Nr: 183

V E N D I M

P Ë R

SHQYRTIMIN ADMINISTRATIV TË DENONCIMIT TË ORGANIZATËS
“QENDRESA QYTETARE” NDAJ ZJ. EMIRIANA SAKO, KANDIDAT PËR
KRYETAR TË BASHKISË DURRËS, Z. ARBEN AHMETAJ MINISTËR I SHTETIT
PËR RINDËRTIMIN DHE PROGRAMIN E REFORMAVE DHE SUBJEKTIT
ZGJEDHOR “PARTIA SOCIALISTE E SHQIPËRISË”, PËR SHKELJE
ADMINISTRATIVE NË KUADËR TË FUSHATËS ZGJEDHORE, PËR ZGJEDHJET
E PJESSHME PËR KRYETAR BASHKIE TË DATËS 6 MARS 2022

Sot më datë 30 Qershor 2022, Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve mori në shqyrtim në seancë dëgjimore denoncimin që u përket:

Kërkues: Organizata “Qendresa Qytetare”

Objekti: Kryerja e aktiviteteve me karakter publik në kundërshtim me kufizimet e nenit 91 dhe 92 të Kodit Zgjedhor të Republikës së Shqipërisë

Ndaj: Zj. Emiriana Sako, Kandidatit për Kryetar të Bashkisë Durrës,
Z. Arben Ahmetaj Zëvendëskryeministrit, njëkohësisht Ministër i Shtetit për Rindërtimin dhe Programin e Reformave,
Subjektit Zgjedhor “Partia Socialiste e Shqipërisë”

Baza ligjore: Nenet 19, pika 1, shkronja “dh”, “f” dhe ‘n”, pika 2, neni 21, shkronja “dh” dhe 91, 171, pikat 1 e 2, të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008, “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, nenet 23, 60 dhe vijues të ligjit nr. 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”, vendimi nr. 9, datë 24.12.2020, i Komisionit Rregullator në Komisionin



Qendror të Zgjedhjeve, “Për rregullat për raportimin e veprimtarive me karakter publik të institucioneve publike, agjencive dhe/ose ndërmarrjeve shtetërore, kategoritë e veprimtarive të ndaluara, si dhe monitorimin e veprimtarisë, sjelljes dhe përdorimit të burimeve njerëzore, financiare dhe logjistike të administratës shtetërore para zgjedhjeve”, vendimi nr. 9, datë 09.03.2021, i Komisionit Rregullator në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve, “Për procedurat e funksionimit dhe mirëmbajtjes së portalit, procedurat dhe afatet e hetimit administrativ të denoncimeve dhe vendimin që merret në përfundim të tyre”.

Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve, pasi shqyrtoi dokumentacionin e paraqitur nga administrata gjatë procesit të hetimit administrativ,

V Ë R E N:

I. Vlerësimi paraprak

1. Pranë Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, në datën 05.03.2022, në portalin e denoncimeve në faqen zyrtare të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, është raportuar nga Organizata “Qendresa Qytetare” denoncimi me nr. 3708 ID, ku pretendohet se, në kundërshtim me Kodin Zgjedhor dhe vendimin nr. 9, datë 24.12.2020 të Komisionit Rregullator, në datë 03.03.2022, në Njësinë Administrative të Manzës, kandidatja e Partisë Socialiste të Shqipërisë, zj. Emiriana Sako, e shoqëruar nga Zëvendëskryeministri njëkohësisht dhe Ministër i Shtetit për Rindërtimin dhe Programin e Reformave, z. Arben Ahmetaj, me pjesëmarrjen e banorëve të zonës, përfitues nga këto investime, promovuan zonën e re të banimit në Manëz, ku kanë përfunduar disa njësi banimi.
2. Sipas denoncuesit, *“Në datë 03.03.2022 në Njësinë Administrative të Manzës, kandidatja e Partisë Socialiste të Shqipërisë, zj. Emiriana Sako, e shoqëruar nga zv.kryeministri njëkohësisht dhe Ministër i Shtetit për Rindërtimin dhe Programin e Reformave, z. Arben Ahmetaj, me pjesëmarrjen e banorëve të zonës, përfitues nga këto investime, promovuan zonën e re të banimit në Manëz, ku kanë përfunduar disa njësi banimi.*
Gjatë këtij takimi, sikurse vërehet nga statusi në profilin personal në Facebook të kandidates, zj. Emiriana Sako dhe z. Arben Ahmetaj, në këtë takim është bërë promovimi i investimeve vendore në atë zonë duke mbështetur dhe promovuar objekte të rindërtuara si pasojë e fatkeqësive natyrore. Ky aktivitet vjen në një kohë që përkon me fushatën zgjedhore.
Gjatë këtij takimi, sikurse vërehet nga statusi në profilin personal në “Facebook” të z. Ahmetaj, shprehet se: “Sot së bashku me Anin në zonën e re të banimit në Manëz, ku kanë përfunduar 9 pallate me rreth 230 apartamente për familjet që në ditët në vijim do të marrin



në dorë çelësat, krahas 236 banesave individuale.”. Pamjet nga ky aktivitet janë publikuar gjithashtu në website-in <https://rindertimi.gov.al/>.

Ndër të tjera, në ndërfaqen e raportimeve në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve, rezulton një takim i raportuar nga bashkia Durrës në datë 01.03.2022, i cili i referohet një takimi me titull “Inspektim në terren në sitin e Manzës” i cili nuk përmbush kriteret e parashikuara nga neni 92, i Kodit Zgjedhor për sa i përket elementëve si afati 5 ditor i raportimit në ndërfaqe, lloji dhe folësit kryesorë të takimit ku ndër to mungon z. Ahmetaj”.

3. Sipas përcaktimeve të nenit 23, të ligjit nr. 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”, Komisioni Shtetëror i Zgjedhjeve shqyrtoi paraprakisht kërkesat lidhur me kompetencën e organit publik për shqyrtimin e tij.
4. Sipas përcaktimeve të neneve 19, pika 1, shkronja “dh”, “f” dhe “n” e pika 2, të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008, “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve ka kompetencat si më poshtë:
 - dh) kujdeset për zbatimin e këtij ligji në mënyrë të drejtë, të përpiktë, të saktë dhe uniforme nga të gjitha institucionet, subjektet apo personat e ngarkuar me detyra dhe detyrime, sipas ligjit;
 - f) monitoron nëpërmjet administratës së KQZ-së apo subjekteve të kontraktuara sjelljen e institucioneve publike gjatë fushatës dhe përdorimin e burimeve publike;
 - n) ushtron në emër të KQZ-së kompetencat që i ngarkohen asaj me ligje të veçanta, si dhe çdo kompetencë që ky ligj nuk ia njeh shprehimisht Rregullatorit ose KAS-it.
5. Referuar nenit 82, e vijues të ligjit nr. 44/2015, “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”, KQZ çmon se të dhënat e paraqitura nga subjekti kallëzues “Qendresa Qytetare” përbëjnë indicie të besueshme për të filluar një procedurë administrative ndaj të denoncuarve, zj. Emiriana Sako kandidate për kryetar të Bashkisë Durrës, z. Arben Ahmetaj Ministër i Shtetit për Rindërtimin dhe Programin e Reformave si dhe subjektit zgjedhor “Partia Socialiste e Shqipërisë”.
6. Në lidhje me të denoncuarin, subjektin zgjedhor “Partia Socialiste e Shqipërisë”, Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve vlerëson se, duke ju referuar vendimit nr. 19, datë 31.05.2022, të Komisionit të Ankimeve dhe Sanksioneve, ku thuhet se *“Zgjedhjet e pjesshme vendore të datës 6 Mars 2022 ishin zgjedhje për kryetar bashkie, por jo për këshillat bashkiake. Për shkak se kandidati për kryetar bashkie trajtohet nga Kodi si subjekt zgjedhor i mëvetësishëm, atëherë në këto zgjedhje duhet trajtuar subjekt zgjedhor përfitues kandidati dhe jo partia politike që e mbështet atë”,* subjekti zgjedhor “Partia Socialiste e Shqipërisë” nuk mund të përfshihet në këtë procedim administrativ. Pavarësisht se ka qenë



subjekt i denoncimit, për arsyen e sipërpërmendur, nuk mund të jetë subjekt i hetimit administrativ.

7. Në këto kushte, Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve çmon të vijojë procedurën administrative ndaj zj. Emiriana Sako kandidatë për kryetar të Bashkisë Durrës dhe z. Arben Ahmetaj Ministër i Shtetit për Rindërtimin dhe Programin e Reformave, për të cilët atribuohen veprimtari administrative që vijnë në kundërshtim me parashikimet e Kodit Zgjedhor dhe vendimit nr. 9, datë 24.12.2020, të Komisionit Rregullator në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve.

II. Rrethanat e faktit

8. Në denoncimin e raportuar pretendohet se, në kundërshtim me vendimin nr. 9, datë 24.12.2020, të Komisionit Rregullator në KQZ, kandidatja për kryetare e Bashkisë Durrës, zj. Emiriana Sako dhe z. Arben Ahmetaj Ministër i Shtetit për Rindërtimin dhe Programin e Reformave, me pjesëmarrjen e banorëve të zonës, përfitues nga këto investime, kanë bërë promovimin e investimeve vendore në Njësinë Administrative të Manzës, duke mbështetur dhe promovuar objekte të rindërtuara si pasojë e fatkeqësive natyrore. Ky aktivitet vjen në një kohë që përkon me fushatën zgjedhore.
9. Referuar denoncimit të mësipërm, Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve me shkresat nr. 1600 prot., datë 05.03.2022 dhe nr. 2337 prot., datë 09.05.2022, ka kërkuar informacion nga zj. Emiriana Sako, kandidat për kryetar të Bashkisë Durrës, z. Arben Ahmetaj Zëvendëskryeministër dhe njëkohësisht Ministër i Shtetit për Rindërtimin dhe Programin e Reformave si dhe z. Muharrem Sula Administrator i Njësisë Administrative Manëz.
10. Me shkresën nr. 1800 prot., datë 17.03.2022 drejtuar Bashkisë Durrës, Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve ka kërkuar informacion në lidhje me financimin e rindërtimit të banesave të dëmtuara nga tërmeti i datës 26 Nëntor 2019 dhe nëse nga ana e Bashkisë Durrës ka pasur fonde publike të vëna rishtazi apo posaçërisht në dispozicion për rindërtimin e këtyre banesave.
11. Me shkresën nr. 1426/1 prot., datë 10.03.2022, administruar pranë Komisionit Qendror të Zgjedhjeve me nr. 1600/1, datë 10.03.2022, Zëvendëskryeministri dhe Ministri i Shtetit për Rindërtimin dhe Programin e Reformave, sqaron se: *“...Zëvendëskryeministri dhe Ministri i Shtetit për Rindërtimin dhe Programin e Reformave ka marrë pjesë në këtë event në cilësinë e të ftuarit në kuadër të procesit të rindërtimit”*.



12. Nëpërmjet shkresës nr. 2257/1 prot., datë 11.03.2022, administruar nga Komisioni Qendror i Zgjedhjeve me nr. 1742 prot., datë 15.03.2022, Bashkia Durrës sqaron si vijon: *“...institucioni i Bashkisë Durrës ka raportuar sipas legjislacionit të sipërcituar në fuqi nëpërmjet raportimit të cilin po jua vëmë në dispozicion për zhvillimin e aktivitetit në datën 03.03.2022 në orën 11:00. Objekti i këtij raportimi, i cili është bërë më datë 02.03.2022 në ndërfaqen e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, ka qenë inspektimi në terren në sitin e Manzës. Inspektimi i kryer nga institucioni organizues i këtij takimi, Bashkia Durrës, siç u citua edhe më sipër është bërë më datën 02.03.2022, kjo për arsye objektive që lidhen me agjendën e ngjeshur të zv.kryeministrit z. Arben Ahmetaj dhe alertimit të gjendjes së krizës botërore të krijuar nga lufta në Ukrainë, fakt i cili na është komunikuar nga kabineti i z. Ahmetaj. Në planifikimin e takimeve të kryetares së Bashkisë Durrës zj. Sako, vizioni i këtij takimi ka qenë inspektimi periodik i sitit të Manzës dhe pa patur në asnjë moment qëllimin e promovimit të investimeve në zonë... Inspektimi i bërë herë pas here nga ana e subjektit Qendresa Qytetare lidhur me rastin konkret por edhe raste të tjera referuar fotove të publikuara në facebook mund të marrin interpretime nga më të ndryshmet. Facebook është një sit publikimesh jozyrtare që nuk përfaqësojnë median në kuptimin e plotë të fjalës dhe interpretimet e bëra nuk reflektojnë atë që ka ndodhur realisht. Inspektimi i sitit është gjë tjetër dhe promovimi i investimeve është gjë tjetër.”*
13. Referuar kërkesës për informacion në lidhje me financimin e rindërtimit të banesave të dëmtuara nga tërmeti i datës 26 Nëntor 2019, Bashkia Durrës, me shkresën nr. 2583/1 prot., datë 25.03.2022, administruar nga Komisioni Qendror i Zgjedhjeve me nr. 1923 prot., datë 28.03.2022, sqaron se, *“...financimet e fundit në kuadër të rindërtimit të banesave të dëmtuara nga tërmeti i datës 26 Nëntor 2019 i përkojnë periudhës Dhjetor 2021, si edhe theksojmë që nga ana e Bashkisë Durrës nuk ka pasur fonde publike të vëna rishtazi apo posaçërisht në dispozicion për rindërtimin e këtyre banesave.”*
14. Me shkresën nr. 262/1 prot., datë 09.06.2022, administruar nga Komisioni Qendror i Zgjedhjeve me nr. 2525/1 prot., datë 13.06.2022, Administratori i Njësisë Administrative Manëz z. Muharrem Sula bën me dije se, *“...organizimi i takimit është raportuar dhe organizuar nga Bashkia Durrës sipas legjislacioneve përkatëse në fuqi, ku qëllimi i këtij takimi ka qenë inspektimi i sitit të Manzës dhe pa patur qëllim promovimit të investimeve në zonë. Për sa i përket denoncimit nga ana e subjektit Qendresa Qytetare lidhur me këtë rast referuar publikimit të fotove në facebook mund të marrin interpretime të ndryshme nga qëllimi real i inspektimit të kryer.”*

15. Për shkak të kompleksitetit të çështjes objekt shqyrtimi, pas përfundimit të afatit 60 (gjashtëdhjetë) ditor të shqyrtimit të këtij denoncimi, Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve, me vendimin nr. 156, datë 05.05.2022, vendosi zgjatjen e afatit të shqyrtimit administrativ të denoncimit të Organizatës “Qendresa Qytetare” ndaj zj. Emiriana Sako, kandidate për kryetar të Bashkisë Durrës, z. Arben Ahmetaj Zëvendëskryeministër dhe njëkohësisht Ministër i Shtetit për Rindërtimin dhe Programin e Reformave dhe subjektit zgjedhor “Partia Socialiste e Shqipërisë”, për shkelje administrative në kuadër të fushatës zgjedhore, në zgjedhjet e pjesshme për kryetar bashkie të datës 6 Mars 2022.
16. Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve, në vijim të procesit të hetimit administrativ të plotë dhe të gjithanshëm, me shkresën nr. 2525 prot., datë 31.05.2022, i përcjell për njohje palëve në proces kopje të njehsuar me origjinalin të shkresave: nr. 1426/1 prot., datë 10.03.2022, administruar me tonën nr. 1600/1 prot., datë 10.03.2022, të Zëvendëskryeministrit dhe Ministrit të Shtetit për Rindërtimin dhe Programin e Reformave; nr. 2257/1 prot., datë 11.03.2022, administruar me tonën nr. 1742 prot., datë 15.03.2022, të Bashkisë Durrës; nr. 2583/1 prot., datë 25.03.2022, administruar me tonën nr. 1923 prot., datë 28.03.2022, të Bashkisë Durrës.
17. Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve, me shkresën nr. 2753 prot., datë 20.06.2022, bazuar në përcaktimet e nenit 47 dhe 87, të ligjit nr. 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative”, ka njoftuar palët zyrtarisht dhe në mënyrë elektronike për zhvillimin e seancës dëgjimore, më datë 23 Qershor 2022, ora 11:30, me palë Organizata “Qendresa Qytetare”, zj. Emiriana Sako, kandidate për kryetar të Bashkisë Durrës, z. Arben Ahmetaj Zëvendëskryeministër dhe njëkohësisht Ministër i Shtetit për Rindërtimin dhe Programin e Reformave.
18. Në seancë dëgjimore u paraqitën palët në proces, organizata “Qendresa Qytetare” me përfaqësues të saj zj. Teisa Kurti dhe z. Migen Qiraxhi, përfaqësuesja e Ministrit të Shtetit për Rindërtimin dhe Programin e Reformave zj. Solora Llatja si dhe përfaqësuesi i Bashkisë Durrës z. Vangjel Manushi.
19. Gjatë pretendimeve të saj, përfaqësuesi i organizatës “Qendresa Qytetare” zj. Kurti u shpreh se, *“Për sa i përket rrethanave të faktit, ne kemi denoncuar aktivitetin e datës 3 Mars në Njësinë Administrative Manëz ku kandidatja e Partisë Socialiste të Shqipërisë dhe Kryetarja e Bashkisë Durrës, shoqëruar nga Zëvendëskryeministri dhe njëkohësisht Ministri i Shtetit për Rindërtimin dhe Programin e Reformave, me pjesëmarrjen edhe të banorëve të zonës përfitues nga ky investim, promovojnë zonën e re të banimit në Manëz, ku kanë përfunduar njësitë e banimit. Gjatë këtij takimi, siç vihet re nga statusi në profilin personal të kandidates*

dhe të z. Ahmetaj, në këtë takim është bërë promovimi i investimit vendor dhe mbështetja e rindërtimit të objekteve si pasojë e fatkeqësive natyrore. Ky aktivitet vjen vetëm tre ditë para zgjedhjeve të pjesshme të datës 6 Mars dhe shkel hapur nenin 91 pasi nuk mund të përdoren ose të vihen në mbështetje të kandidatëve, të partive politike ose të koalicioneve burime ose asete publike, por edhe në kuptim të burimeve njerëzore në referim të nenit 142 të Kodit Civil. Gjithashtu në referim të nenit 6, pika 3, punonjësit të administratës shtetërore i ndalohej të përdorë të mira publike, funksionin ose veprimtarinë shtetërore ose burimet financiare, materiale, njerëzore, me qëllim favorizimin e një partie politike, koalicioni ose kandidati në zgjedhje. Në këtë rast, z. Ahmetaj, për sa është pohuar edhe në shkresat zyrtare, gjendet në cilësinë e Ministrit pranë kandidatës vetëm tre ditë para zgjedhjeve. Për sa është thënë edhe në profilin zyrtar të z. Ahmetaj dallohet qartazi elementi i premtimeve elektorale. Ndër të tjera do donim të ndaleshim në praninë e shtuar të banorëve ku në kuadër të këtij inspektimi. Gjithashtu, në ndërfaqen e raportimeve rezultoi një takim i raportuar nga Bashkia Durrës i cili i referohet një takimi me titull “Inspektim në terren në sitin e Manzës” i cili nuk përmbush kriteret e nenit 92 të Kodit Zgjedhor për sa i përket elementeve si afati 5 ditor i raportimit në ndërfaqe.

20. Përfaqësuesi i kandidatës për kryetar bashkie Durrës, z. Manushi parashtroi si vijon: “Kryetarja e Bashkisë Durrës, në pozicionin e kryetares dhe jo kandidatës ka shkuar të inspektojë sitin e Manzës i cili është në rindërtim, mbështetur dhe nga Zëvendëskryeministri dhe Ministri i Shtetit z. Ahmetaj. Është një procedurë rutinë që titullari i institucionit ndjek punimet në zonat në rindërtim, në funksion të nenit 23 të ligjit për vetëqeverisjen vendore, jo si kandidat për kryetar bashkie por si administrator i ekzekutivit. Prezenca e qytetarëve nuk do të thotë që janë njoftuar nga titullari i institucionit apo nga mediat, por kjo prezencë është e ndjeshme në atë zonë sepse rindërtimi është një problem madhor jo vetëm për Durrësin por për pjesën më të madhe të qyteteve që janë goditur nga tërmeti. Nuk është bërë promovim i punës së bashkisë dhe prezenca e Zëvendëskryeministrit është në funksion të rindërtimit.
21. Përfaqësuesja e Zëvendëskryeministrit dhe Ministrit të Shtetit për Rindërtimin dhe Programin e Reformave zj. Solora Llatja parashtroi se, “Prezenca e z. Ahmetaj ka qenë në cilësinë e të ftuarit, në kuadrin e Ministrit për Rindërtimin në 11 bashki të cilat janë duke zbatuar programin e rindërtimit. Manza është një njësi administrative me një sipërfaqe 43.25 km² dhe me një popullsi prej 11 681 banorë. Me rindërtimin në Manzë kemi 133 banesa individuale, rindërtimin e rrjetit të ri rrugor dhe infrastrukturës, zona të reja zhvillimi që përfshijnë 9 blloqe banimi dhe akomodojnë 226 familje. Ky është një numër i mjaftueshëm për të pasur banorë në momentin e inspektimit. Kjo nuk do të thotë që banorët janë lajmëruar



apo detyruar të marrin pjesë. Në cilësinë e të ftuarit kemi qenë brenda rregullave për të inspektuar një sit në ndërtim. Për shkak të agjendës së ngarkuar të Ministrit, takimi është konfirmuar katër ditë para dhe raportimi nga Bashkia Durrës është bërë tre ditë para. Por kjo nuk ka ardhur si pjesë e promovimit të kandidatës apo partisë por si pjesë e promovimit të programit të rindërtimit”.

22. Në pretendimet përfundimtare, pas shpalljes së mbylljes së hetimit administrativ, denoncuesi kërkoi konstatimin e shkeljeve dhe marrjen e sanksioneve administrative ndaj kandidatës për kryetar bashkie Durrës zj. Eriselda Sefa, Ministrit të Shtetit për Rindërtimin dhe Programin e Reformave z. Arben Ahmetaj dhe Partisë Socialiste. Përfaqësuesi i bashkisë Durrës dhe përfaqësuesi i Ministrit të Shtetit për Rindërtimin dhe Programin e Reformave kërkuan rrëzimin e pretendimeve të Organizatës “Qendresa Qytetare”.

III. Analiza ligjore

23. Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve vlerëson se, në kuptim të pikës 1, të nenit 92 të Kodit Zgjedhor i cili parashikon se, *“Formojnë veprimtari publike të gjitha veprimtaritë që janë të hapura për pjesëmarrjen e publikut apo të medias, si dhe ato që kanë në agjendë informimin, në periudhën katër muaj para datës së zgjedhjeve deri ditën e zgjedhjeve, e publikut rreth tyre”*, veprimtaria e kryer në Njësinë Administrative Manëz për të inspektuar punimet përbën një veprimtari me karakter publik, pasi ka pasur pjesëmarrjen e banorëve të zonës.
24. Referuar nenit 92, të Kodit Zgjedhor parashikohet se, *“Institucionet publike, qendrore dhe vendore, si dhe agjencitë dhe/ose ndërmarrjet shtetërore, janë të detyruara të raportojnë në KQZ të gjitha veprimtaritë me karakter publik që planifikojnë të zhvillojnë në periudhën katër muaj para datës së zgjedhjeve deri ditën e zgjedhjeve”*. Nga materialet e dosjes hetimore administrative dhe nga kërkimet e bëra në faqen e raportimeve të KQZ-së rezulton se takimi është raportuar në ndërfaqen e raportimeve në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve.
25. Neni 3, pika 1, nënndarja 1.1, shkronja “d”, e vendimit nr. 9, datë 24.12.2020, të Komisionit Rregullator në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve, parashikon se *“Veprimtari të ndaluara për t’u promovuar janë veprimtaritë publike sipas përkufizimit të nenit 2 të këtij vendimi, për të cilat janë vënë rishtazi apo posaçërisht në dispozicion, apo janë transferuar fonde publike jo sipas planit buxhetor të miratuar, në periudhën 4 (katër) mujore para datës së zgjedhjeve dhe që përfshijnë mbështetjen dhe promovimin e objekteve të rindërtuara ose në proces rindërtimi për shkak të fatkeqësive natyrore”*.



26. Neni 3, pika 1, nëndarja 1.1, e kufizon fushën e veprimit në ato veprimtari publike për të cilat janë vënë rishtazi apo posaçërisht në dispozicion, apo janë transferuar fonde publike jo sipas planit buxhetor të miratuar, në periudhën 4 (katër) mujore para datës së zgjedhjeve. Në mënyrë që të kemi shkelje të shkronjës “d” “...mbështetjen dhe promovimin e objekteve të rindërtuara ose në proces rindërtimi për shkak të fatkeqësive natyrore”, duhet që fondet e përdorura për mbështetjen, promovimin e këtyre objekteve të ishin vendosur rishtazi apo posaçërisht në dispozicion dhe të ishin transferuar jo sipas planit buxhetor të miratuar, në periudhën 4 (katër) mujore para datës së zgjedhjeve. Këto janë kushte kumulative të përcaktuara nga neni 3, dhe nuk mund të lexohen të ndara nga njëra-tjetra. Në rastin konkret nuk kemi të bëjmë me veprimtari me fonde të vëna rishtazi dhe as me fonde publike të transferuara jo sipas planit buxhetor të miratuar.
27. Kryetari i bashkisë Durrës, njëkohësisht edhe kandidat për kryetar bashkie, zj. Emiriana Sako është paraqitur pranë zonës ku po kryhet investimi, në kuadër të vizitave inspektuese të herëpashërëshme që kryetarja e bashkisë kryen në zbatim të funksioneve dhe detyrave të njësisë të vetëqeverisjes vendore. Nga hetimi administrativ i kryer dhe nga provat materiale të administruara në dosjen hetimore administrative, Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve vlerëson se, veprimtaria e mësipërme është në përmbushje të detyrave funksionale të Kryetarit të Bashkisë.
28. Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve vlerëson të rëndësishme të sqarojë se zj. Sako është në funksionin e Kryetarit të Bashkisë dhe jo atë të kandidatit për kryetar bashkie, si dhe z. Ahmetaj në funksionin e Ministrit të Shtetit për Rindërtimin dhe Programin e Reformave dhe jo në atë të Zëvendëskryeministrit, si autoritet përgjegjës për përballimin e pasojave të fatkeqësisë natyrore, ndër të tjerash edhe ministri përgjegjës në fushën e përgjegjësisë të të cilit përfshihet përballimi i pasojave nga fatkeqësia natyrore dhe fatkeqësi të tjera. Akti Normativ nr. 9, datë 16.12.2019 “Për përballimin e pasojave të fatkeqësisë natyrore” ka përcaktuar në nenin 12, shkronjat “c” dhe “d” dhe në aktet e tjera të dala në funksion tij se, pjesë e detyrave funksionale në shërbim të procesit të rindërtimit të kryetarëve të bashkisë, administratorëve të njësisë bashkiake dhe ministrit përgjegjës është monitorimi, vizitat në terren dhe inspektimi i standardeve të ndërtimit, në mënyrë që të bëhet përdorimi eficient i burimeve shtetërore.
29. Kryerja e inspektimit gjatë periudhës zgjedhore nuk e kategorizon këtë takim si takim elektoral pasi ministri dhe kryetari i bashkisë kanë qenë duke kryer detyrat funksionale që ua dikton fusha e përgjegjësisë e përcaktuar me ligje të veçanta. Kryetarët e bashkive që

njëkohësisht kandidojnë në zgjedhjet vendore për të njëjtin pozicion, nuk heqin dorë nga detyra e tyre gjatë periudhës që ata janë kandidatë.

30. Për sa më sipër, nga hetimi administrativ i kryer dhe nga provat materiale të administruara në dosjen hetimore administrative, Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve vlerëson se kryerja e inspektimit në zonën e re të banimit në Manëz nga zj. Sako dhe z. Ahmetaj ka qenë në përmbushje të detyrave të tyre rutinë e funksionale dhe nuk përmban fakte dhe rrethana që përfshihen në fushën e zbatimit të ndalimeve të përcaktuara në nenin 91 të Kodit Zgjedhor dhe në nenin 3, të vendimit nr. 9, datë 24.12.2020, të Komisionit Rregullator në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve.

PËR KËTO ARSYE:

Bazuar në nenin 19, pika 1, shkronjat “dh”, “f” dhe “n”, pika 2, nenin 21 shkronja “dh”, nenin 91 dhe 92, nenin 171, pikat 1 e 2, të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008, “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, nenin 23, 60 dhe vijues të ligjit nr. 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”, vendimin nr. 9 datë 24.12.2020 dhe vendimin nr. 9, datë 09.03.2021, të Komisionit Rregullator në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve,

V E N D O S I:

1. Përfundimin e shqyrtimit administrativ të denoncimit ndaj zj. Emiriana Sako, kandidat për kryetar të Bashkisë Durrës, z. Arben Ahmetaj Ministër i Shtetit për Rindërtimin dhe Programin e Reformave dhe subjektit zgjedhor “Partia Socialiste e Shqipërisë”.
2. Pushimin e hetimit administrativ ndaj Partisë Socialiste të Shqipërisë.
3. Moskonstatimin e shkeljes nga ana e zj. Emiriana Sako, kandidat për kryetar të Bashkisë Durrës, dhe z. Arben Ahmetaj Ministër i Shtetit për Rindërtimin dhe Programin e Reformave.
4. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen zyrtare të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve.
5. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim brenda 30 (tridhjetë) ditëve nga shpallja e tij, në Komisionin e Ankimeve dhe Sanksioneve.

Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve

Ilirjan CELIBASHI

